

Vetëvendosje sepse...

- Vetëvendosje, sepse çdo popull ka të drejtë të zgjedh lirshëm rrugën e ndërtimit të fatit kolektiv.
- Vetëvendosja është kushti themelor i lirisë. Gjithçka më pak është joliri. Joliria është e padrejtë. Padrejtësia është e papranueshme. Luftoje padrejtësinë !
- Vetëvendosje, sepse liria kolektive është kushti fundamental i lirisë individuale.
- Vetëvendosje, sepse burim i vetëm i sovranitetit është populli dhe askush tjetër.
- Vetëvendosje, sepse çdo popull ka të drejtë të dekolonizohet.
- Vetëvendosje, sepse sa herë kanë vendosur tjerët për ne, e jo ne për veten, kemi qenë të shtypur.
- Vetëvendosje, sepse zgjidhja është liria, dhe ajo ndodh vetëm atëherë kur kjo çështje nuk lihet në ndërgjegjen e pushteteve në Beograd.
- Vetëvendosje, sepse problemi zgjidhet jo atëherë kur synohet ndryshimi i opinionit të brendshëm serb për Kosovën, por atëherë kur Kosova pushon së qeni objekt i këtij opinionit.
- Vetëvendosja është goditje e fuqishme ndaj çfarëdo aspiratash hegjemoniste.
- Vetëvendosja është mbyllje e shtegut të së keqes.
- Vetëvendosja ndikon në denazifikimin e Serbisë.
- Vetëvendosje, sepse ky është minimumi i kompensimit moral për padrejtësinë shekullore, represionet e vazhdueshme, shkeljen e pandërprerë të dinjitetit, qindra mijëra dhunime dhe dhjetëra mijëra vrasje, shkatërrime dhe dëme të përgjithshme.
- Vetëvendosje, sepse kjo është diçka e natyrshme: është gjë e pritshme të vendosim në interes të vetes më shumë seç do ta bënte këtë tjetërkush dhe gjithkush tjetër për ne.
- Vetëvendosje! Pa kusht. Deri në shkëputje përfundimtare. Deri në çlirim të plotë të vendit.